



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI,
TË MBAJTUR MË 13 MAJ 2015**

**SA JAVNE DEBATE KOMISIJE ZA EKONOMSKI RAZVOJ,
INFRASTRUKTURU, TRGOVINU I INDUSTRIJU, ODRŽANE 13 MAJA 2015.
GODINE**

**MAJ – MAJA
2015**

KRYESUESI RAI F QELA: Të nderuar të pranishëm,
Po fillojmë dëgjimin publik lidhur me Projektligjin për digjitalizimin e transmetimeve radio-difuzive tokësore numër 05/L-27.

Siç e dini para disa ditësh në parim ky projektligj u miratua nga Kuvendi i Kosovës pasi që i kaloj procedurat paraprake të nevojshme. Sot jemi këtu për dëgjim publik, do të bëjmë përpjekje që më pak të flasim institucionet e më shumë palët tjera të interesuara.

Përshëndes të gjithë të pranishmit,
Përfaqësuesit e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik,
Përfaqësuesit e ARKEP-it, të AMPEK-ut,
Komisionit të Pavarur të Mediave, dhe
Të gjitha mediat të pranishëm këtu,

Në këtë përbërje janë pjesë të dy grupeve punuese të Kuvendit të Republikës së Kosovës - Grupi Punues i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë Tregti dhe Industri dhe Grupi Punues për Administratë Publike dhe Media, si një Komision një grup punues i përbashkët që do të punoj tani e tutje lidhur me këtë projektligj.

Fillimisht do t'ia jap fjalën kryetarit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti e Industri, deputetit Muhamet Mustafa. Urdhëroni!

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit!

Ju përshëndesë të gjithëve,
Përshëndes kolegun tim, zotëri Pajazitin, që është këtu,
Ju faleminderit, për pjesëmarrje të gjithëve, sidomos përfaqësuesve të mediave por gjithashtu edhe të agjencioneve të pavarura siç është AKREP-i edhe Komisioni i Pavarur i Mediave, gjithashtu përfaqësuesit e Ministrisë së Zhvillimit.

Ne kemi pasur një debat këtu para 2-3 javësh debatin fillestar me Komision dhe duke marrë parasysh se digjitalizimi i transmetimeve radiodifuzive është një proces jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe se jemi në vonesë me këtë proces. Ne kemi aprovuar në parim që ky ligj të shkoj në Kuvend, në Kuvend ka kalua në leximin e parë, është aprovua por është konkluda që në mes të dy leximeve të bëhet një konsultim i gjithanshëm me gjithë akterët e interesuar në mënyrë që të merren mendimet që ndonëse na duhet të veprojmë me shpejtësi në draftimin dhe në aprovimin e këtij ligji mos të kalojnë fazat e nevojshme të dëgjimit publik dhe të ... interesave të gjithë akterëve gjatë procesit të aprovimit të tij. Prandaj edhe është organizua ky dëgjim publik, kryesisht me akterët e interesuar dhe me mediat që ofrojnë transmetime radio-difuzive edhe televizionet përkatëse. Ne konsiderojmë se aprovimi i këtij ligji është shumë i rëndësishëm jo vetëm pse ne i shoqërohem i gjithë procesit që është në rajonin tonë dhe në Evropë por ajo që është më e rëndësishme është se ne nëpërmjet digjitalizimit do të kursejmë do të bëhemi më eficient në shfrytëzimin e frekuencave të cilat janë një resurs mjaftë i rrallë, mjaftë i çmueshëm për ne, domethënë lirohen hapësira në frekuenca dhe krijohet mundësi për zhvillim më tutje.

Në këtë drejtim ne duhet të bëjmë zgjedhje të përgjegjshme po them si në aspektin e interesit publik, në aspektin e operatorëve dhe radio-televizioneve ku duhet të mbrohet interesi publik, të

mbrohet konkurrenca e barabartë dhe jo vetëm për një moment por të bëjmë aso zgjidhje të cilat nuk e pengojnë zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori shumë të rëndësishëm për shoqërinë tonë dhe shih për këtë ne jemi të interesuar që të kemi një debat po them konstruktiv i cili edhe nga aspekti i Qeverisë dhe i Kuvendit i merr parasysh këto tri interesa i valorizon njësoj por gjithmonë ne e kemi primarë interesin publik ajo është shfrytëzimi sa më racional dhe ekonomik i këtij resursi që i kem frekuencat edhe për gjeneratat e tashme, edhe për gjeneratat e ardhshme duke sigurua barazinë dhe konkurrencën në treg, informimin e drejtë duke e mbrojt edhe interesin e organizatave që tash funksionojnë në këtë sektor, por edhe mundësuar zhvillimin e mëtejshëm edhe të këtyre organizatave edhe të operatorëve të ri. Kjo është ajo që ne dëshirojmë këtu, prandaj ju lus që sot të jepni vërejtjet e juaja gjithmonë duke pasur parasysh në këtë drejtim, në këtë trekëndësh interesash që thash ku primarë është interesi publik dhe i informimi i opinionit në mënyrë të drejtë, në mënyrë reale në kohën reale dhe në mënyrë të pavarur.

Ju falënderoj për pjesëmarrje edhe një herë dhe siç tha edhe kryetari i grupit punues zoti Raif Qela. Ne sot jemi të interesuar më shumë të dëgjojmë prej jush, prandaj grupi punues që është krijuar prej dy komisioneve do t'i merr amendamentet, do t'i propozojnë, ne do t'i trajtojmë në Komision dhe do t'i dërgojmë në procedurë në Kuvend por gjithmonë me një objektivitet maksimal. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryetar!

Tani fjalën e ka kryetari i Komisionit për Administratë Publike dhe Media, zoti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues, zoti Qela,

Zoti kryetar i Komisionit Mustafa,

Të nderuar deputetë,

Përfaqësues të mediave dhe të institucioneve tjera,

Dëshiroj të ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe të ju konfirmoj po ashtu si zoti Mustafa që ne kemi një gatishmëri që dy komisionet të punojnë bashkë në mënyrë që ky projektligj të dal sa më mirë dhe sa më shpejtë.

Mendoj që është një moment i rëndësishëm për ju si media, ju mund ta cilësoni si të doni po për nga avancimi dhe për nga kërkesa që i kem nga institucionet e rëndësishme ky është ndër ligjet që radhitet me kriteret për procesin tonë të integriteteve në BE, por më shumë se kaq është një shkallë e rëndësishme e avancimit dhe mendoj që ne kemi pasur për detyrë që tash më me kohë ndoshta edhe më herët ta nxjerrim këtë ligj.

Është një farë paradoksi tash se strategjia prej Komisionit të Mediave u diskutua më shumë me ne si Komision tash ligji është me Komisionin tjetër parlamentar por si do që të jetë ne jemi dakordua që bashkë të jemi në gjithë procesin dhe besoj që gjithçka do të shkoj mirë. Po më shumë se sa ana jonë e parlamentit mendoj që është në dorën tuaj si media si Komision i Pavarur i Mediave, si arket të punon ngushtë të gjithë në mënyrë që ne ta kemi më lehtë pastaj për ta përfundua këtë ligj. Gjithçka që do të kërkon ju të dakordoheni ju do të jetë pjesë e këtij ligji dhe mendoj që asnjë nga ne nuk kemi një ide tjetër përpos ta nxjerrim një ligj që e avancojnë këtë sektor që është jashtëzakonisht i rëndësishëm për demokratizimin e këtij vendi për shoqërinë në përgjithësi edhe për ngritjen, përgjegjësi të kapaciteteve tona të shoqërisë dhe institucioneve.

Sa më shpejtë dhe sa më mirë që të punoni bashkërisht aq më lehtë do ta kemi ne si deputetë. Dhe ne jemi të informuar për këtë proces por nuk është e thënë gjithherë që ne i kemi të gjitha dijet për sa i përket këtij sektori. Ju jeni të involvuar vetë me këtë sektor dhe më mirë se ju që e dini ne nuk mund ta dimë, sa më mirë që të na skjaroni ju këtë proces edhe të afroni më afër nesh ne do të mund ta kalojmë këtë ligj.

Ju falënderoj edhe një herë, ju ofroj si Komision do të jemi bashkërisht, është një grup punues i përbërë prej deputetëve të dy komisioneve. Unë mendoj që ka një vullnet të mirë nga deputetët që ky ligj të kaloj në kohën e duhur të aprovohet në parlament. Faleminderit!

KRYESUESI: Tani shkurtimisht, deputeti Blerim Grainca.

BLERIM GRAINCA: Faleminderit!

Kolegë të nderuar,

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Unë nuk do të marrë shumë kohë sepse shumicën e gjërave për nevojën e këtij ligji i thanë kolegët e mijë.

Mirëpo dua të ngre 2-3 çështje të cilat unë gjatë leximit të ligjit qoftë herën e kaluar qoftë tash kam arritur me i vërejt. Fillimisht për mua ajo që kam lexua kam pa se në ligj ka një lloj dualizmi institucional, ne jemi këtu për të dëgjuar opinionet e juaja edhe për të parë reagimet edhe vërejtjet, sugjerimet. Por unë kam pa që ka një bartje të kompetencash, një ngatërrim kompetencash mes KPM-së si kategori kushtetuese, mes AKREP-it dhe institucioneve tjera deri te ajo se kush i bënë vlerësimet dhe krijimin e komisioneve vlerësuese për licenca dhe këtë në vijueshmëri. Po ashtu kam pa që ky draft-ligj ky ligj që është miratua në lexim të parë ka edhe një lloj burokracie përbrenda dhe ngatërrim të tepruara të periudhave dhe afateve brenda të cilave duhet të aplikohet për procedura të caktuara dhe po ashtu duke ditë se roli dhe qëllimi i këtij parlamenti është luftimi i monopoleve.

Unë mendoj që ky ligj në këtë version qysh është tani nuk e kryen atë detyrë, nuk lufton monopole sidomos në fushat të cilat efektet që krijon ky ligj, nëse kish me kalua edhe në lexim të dytë atëherë unë mendoj se ky draft kish me krijuar monopole dhe nuk kish me mundësua një treg të lirë, një konkurrencë të lirë për çka jemi zotua edhe ne si parlament po edhe qeveria aktuale. Po ashtu për mua ka rëndësi edhe kostoja që do të prodhoj ky ligj, për arsye se mendoj se ky ligj në këtë version si është tani nuk ka garanton një kosto financiare të arsyeshme për investime që mund të kenë bë mediat tona deri më tani sepse aq sa di unë mediat i shikojmë edhe si biznese. Prandaj, ky ligj do të duhej t'i mbrojt ato nga një kosto e re që mund të linde nga miratimi i këtij ligj, do të thotë a mbron koston aktuale të investimeve që kanë bërë mediat dhe kostoja e qytetarëve, se mendoj se nëse ky ligj kish me hy në fuqi nëse dom me thjeshtua pak debatin atëherë a nënkupton kjo gjë gjithë ata që e shikojnë televizionin kanë me pagua për atë televizion që shikoj edhe kanë me ndërrua aparaturën përcjellëse ato resivera edhe ato gjëra të tjera. A duhet me ndërrua krejt qytetarët, domethënë interesi publik në këtë rast a është i dikujt më i madh apo është interesi i qytetarëve. Nëse dom me i mbrojt qytetarët duhet me pas a ka alternativa të tjera, a lejohet një sistem i dyfishtë konform mundësive që ka Kosova dhe konform obligimeve ligjore që kem ndaj integriteteve dhe synimeve që kemi.

Unë nuk do të ju marrë shumë kohë, por ju siguroj që Komisioni është i gatshëm me dëgjua të gjitha vërejtjet e juaja dhe me i artikulua edhe me i fut në ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Tani, nëse janë të interesuar përfaqësuesit e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, KPM-së apo ARKEP-it le të urdhërojnë, së pari sipas kësaj renditjeje. Mirë, vazhdojmë përfaqësuesja e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Marcela Restelica Ponoshevc.

MARCELA RESTELICA - PONOSHECI: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar i Komisionit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, shprehë kënaqësinë që Projektligji për digjitalizim është miratuar në lexim të parë dhe shpreson që shumë shpejtë do të miratohet edhe në formën e vetë përfundimtare duke arritur që në këtë mënyrë arrijten e afatit 17 qershor 2015, nëse jo për përfundim të procesit të digjitalizimit atëherë së paku miratimin e projektligjit që do të rregullon këtë proces.

Duhet kujtuar që procesi i hartimit të projektligjit është realizuar qysh në vitin 2013, por për arsye të ndryshme nuk ka ardhur deri te miratimi i tij deri tani. Pasi që Ligji për KPM-në e ka paraparë që procesi i digjitalizimit do të rregullohet me ligj të veçantë, përfaqësuesit e MZHE-së si ministri përgjegjëse për hartimin e legjislacionit për komunikime elektronike dhe pas konsensusit të plotë nga të gjitha palët e përfshira në proces ka filluar me procesin e hartimit të draftit të ligjit.

Për të siguruar që projektligji të përfshijë përvojat më të mira evropiane të deri atëherëshme me procesin e digjitalizimit sfidat kohore dhe resurset e limituara financiare, ne kemi kërkuar dhe përfituar nga Komisioni Evropian mbështetje me asistencë teknike. Gjatë këtij misioni kanë qenë të ftuar dhe kanë marrë pjesë në grupin punues të udhëhequr nga MZHE edhe përfaqësuesit e KPM-së, Rregullatorit të Telekomit, RTK-së, AMPEKU-të dhe të OSBE-së.

Projektligji është dërguar te të gjitha palët e interesit si dhe është publikuar në WEP faqe të MZHE-së. është zhvilluar procesi i konsultimeve publike dhe si rezultat i kemi marrë komente, sugjerime dhe rekomandime konkrete nga KPM, RTK, AMPEK, IPKO, PTK dhe OSBE. Të gjitha këto komente, sugjerime dhe rekomandime janë shqyrtuar me transparencë të plotë nga MZHE-ja së bashku me asistencën teknike gjatë fazës së dytë të misionit TAEIX. Gjatë kësaj periudhe kemi ftuar secilën palë dhe kemi diskutuar për çështjet të ngritura nga ata për përmbajtjen e projektligjit në formën se çka është pranuar, çka nuk mund të pranohet dhe pse. Të gjithë materialin e kemi pranuar nga palët e interesit dhe të përpunuar nga ne në formë tabelash të cilat i kemi bërë publike në WEB faqen tonë.

Tash së fundit, versioni që është miratuar në lexim të parë janë bërë disa ndryshime minore për të akomoduar kërkesat e Ministrisë së Financave për lëshimin e deklaratës financiare pozitive. Propozimet eventuale të palëve të interesit për të amendamentuar paragraf të caktuar që mund të paraqiten gjatë procesit tuaj të diskutimeve publike ne jemi të gatshëm që brenda disa ditësh pas

t'i kemi në dispozicion ato në formë të shkruar t'i japin edhe opinionin tonë si sponzorizues të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, prej jush!

Fjalën e ka përfaqësuesja e Komisionit të Pavarur për Media.

ANITA MORINA - SARAÇI: Faleminderit!

Komisioni i Pavarur i Mediave ka rishikuar edhe një herë projektligjin që ka kaluar në lexim të parë në Kuvendin e Kosovës dhe duke vlerësua se ky projektligj është ndërtuar në bazë të një strategjie e cila nuk ka kaluar në Qeveri herën e parë.

Vlerësojmë se ky projektligj ka disa nene të cilat janë të paqarta dhe duhet që të harmonizohen.

Me qëllim të vlerësimit të harmonizimit të këtij projektligji me Ligjin për KPM dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës, KPM ju ka dërguar edhe më herët juve një listë të neneve të cilat ne vlerësojmë se duhet të ndryshohen. Çështje për të cilat KPM konsideron se duhet të harmonizohen në mënyrë që të mos jenë këto kundërshtime në mes të dy ligjeve Ligji për KPM dhe Ligji për digjitalizim të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ne i kemi fokusuar në disa pika që mos të ju marrim edhe kohë dhe t'i lexojmë të gjitha ato neni. Mirëpo nëse ka nevojë ne ndërkohë mund t'i përsërisim.

Janë nenet e këtij projektligji të cilat vijnë në kundërshtim të plotë me nenin 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në të cilën jepen kompetencat KPM-së për disa çështje që janë këtu të fokusuara. Kundërshtimet në Projektligjin për digjitalizim që janë në kundërshtim me Ligjin për KPM-në dhe përcaktimi i regjional të cilat mundësohen kalimin njëkohshëm të televizionit si atyre regjionale dhe atyre lokale të cilat ne i kemi precizuar në strategji për digjitalizim e cila ka kaluar në Qeverinë e Kosovës dhe ne kërkojmë që ky ligj të ndërtohet duke u bazuar në atë strategji që KPM e ka punuar vlerësoj që së bashku me mediat me që nuk ka pasur vërejtje shumë thelbësore të cilat nuk janë trajtuar aty.

Do të thotë ne i kemi bërë disa dëgjime, ne i kemi bërë disa konferenca me gjithë përfaqësuesit e mediave. Sigurisht që në asnjë rast nuk mund të jenë 100% të kënaqur të gjithë, edhe ne kemi bërë disa lëshime aty ku ka qenë mundësia që të bëhet. Mirëpo nëse ky projektligj kalon ashtu si tani është i propozuar atëherë do të ketë një lomshë brenda institucioneve të Kosovës edhe nuk do të ketë një përcaktim se cila punë kujt i përket.

Ajo që e tha deputeti Grainca, vjen si rrjedhojë e ndryshimeve që janë bërë në Ligjin e KPM-së dhe janë marrë shumë kompetenca Komisionit të Pavarur për Media i cili është Komisioni Organ Kushtetues i themeluar nga Kuvendi i Kosovës. e di që nuk është koha, mirëpo me që u përmend vlerësoj që është një ligj që duhet shumë shpejtë të rishikohet dhe kompetencat të precizohen sikur të KPM-së ashtu edhe të ARKEPI-t.

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Komisioni i Pavarur i Mediave është organ i pavarur që rregullon spektrin e frekuencave të transmetuesit në Republikën e Kosovës, licencon transmetim publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj.

Nëse bazohemi në këtë shumë nene, duke u nisur nga qëllimi i projektligjit duhet të ndryshohen. Të ju marrë si shembull vetëm në nenin 1, te qëllimi i projektligjit ku thuhet ndryshimi në menaxhimin e ...frekuentohet. Kjo faktikisht nuk duhet të ishte këtu për shkak se Kushtetuta e Republikës së Kosovës e përcakton këtë kompetencë si kompetencë të KPM-së e jo të një organi tjetër.

Unë sot nuk do të ju marrë kohë tani edhe pse vlerësoj që këtu ka shumë për të folur, mirëpo në ndërkohë do t'i precizojmë edhe nenet përkatëse se ku ne mendojmë që duhet të jenë ndryshimet.

Dhe, ne sigurisht Komisioni ju ka dërgua një kopje të kësaj, besoj që do ta keni parasysh dhe do të bashkëpunojmë edhe më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani nëse ka nevojë përfaqësuesi i ARKEPI-të.

VISAR HALIMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Shkurtimisht ne do i japim komentet tona teknike pasi t'i pranojmë komentet e KPM-së dhe organeve tjera të AMPEKU-të dhe mediave.

Por ajo që dua të siguroj është se ky projektligj nuk bie në kundërshtim fare me nenin 142 të Kushtetutës për arsye se menaxhimi dhe administrimi janë dy terme të ndryshme dhe për ato në interpretime juridike dhe ligjore do i paraqesim me shkrim.

Tjetra, si Kosovë si vend jemi vonë me proces dhe ne e përhëndesim miratimin në lexim të parë nga Kuvendi dhe inkurajojmë të gjithë aktet që janë prezentë këtu që t'i sqarojnë qëndrimet dhe të japin kontributin që edhe Kosova ta zë hapin me vendet tjera të regjionit.

Natyrisht se strategjia do t'i marrë parasysh investimet e bëra nga operatorët e licencuar dhe ato janë reflektuar në strategji. Por, mendoj që nuk kemi kohë më të debatojmë a duhet strategjia t'i paraprinë miratimit apo ligji. Për arse se në qëllim të ligjit është saktë e precizuar se është ligj teknik i karakterit teknik dhe i punuar nga Komisioni Evropian dhe nga ministria e vijës.

Balancat institucionale janë të siguruara me këtë projektligj dhe procedura është ajo e cila duhet ta përcaktoj fituesin e një gare. Po flasim për dy kanale të cilat me strategji janë përcaktuar si do jepen në garë dhe kjo është shumë e qartë. KPM-ja nuk duhet të ketë asnjë shqetësim për ngathim të kompetencave apo marrje të kompetencave, kjo nuk është e rastit por me një bashkëpunim më të shtuar mund të qartësohen këto ashtu siç tha edhe kryetari Pajaziti.

Ne jemi të gatshëm për mu ju afrua këto sqarime dhe duhet të ecim para. Për komente teknike menaxheri për frekuenca do i paraqes ato masë debatit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Halimi!

Tani i ftoj përfaqësuesit e mediave që ta kërkojnë fjalën dhe ta marrin fjalën secili prej tyre është e udhës që së pari të prezantohet në mënyrë që kjo çështje mund të evidencohet në transkript. Prandaj, fjalën e kërkoj e para Koha Ditore, më falni Flaka Surroi.

FLAKA SURROI: Koha ditore s'është objekt diskutimi sot. Faleminderit, zoti kryesues!

Flaka Surroi, në emër të **AMPEK**-ut, ndoshta pak ato çka do t'i lexoj tash do të tingëllojnë si përsëritje të asaj të cilën e thanë para folësit, por më duket se në një farë forme e përtheqojmë atë që e kemi mendua dhe të cilën e kemi shprehur gjatë gjithë kohës, gjatë gjithë procesit të digjitalizimit si pjesë e industrisë.

Të nderuar deputetë,

Ju faleminderit, shumë për organizimin e këtij dëgjimi publik,

Më lejoni që fillimisht të shprehi keqardhjen për mospjesëmarrjen e kryeshefes ekzekutive dhe kryetarit të Komisionit të Pavarur për Media në këtë mbledhje sot. Pavarësisht pjesëmarrjes shumë të madhe të anëtarëve të KPM-së.

Në fazën e përmbylljes së një procesi kaq të .. dhe të rëndësishëm që e prek direkt publikun e Kosovës si dhe industrinë mediatike. Pjesëmarrja e tyre këtu do të ishte më shumë se sa përmbushja e një obligimi....Vërejtjet tona në tekstin e projektligjit tashmë ja u kemi shpërndarë dhe nuk do të hy t'i elaboroj më gjatë për shkak se ka shumë komente në tekstin e Ligjit që e kemi bërë.

Po se do të doja t'ua tërheqë vëmendjen nga disa çështje që duhet pasur parasysh me rastin e shqyrtimit të vendimit se a duhet kaluar këtë ligj në këtë formë çfarë është sot apo jo. Ky projektligj është versioni i vitit 2013 dhe nuk ka pësua ndryshim për të ju përshtatur dokumentit të strategjisë i cili është miratua në vitin 2015.

Është teksti me prodhimin e të cilit është ngarkuar Ministria e Zhvillimit Ekonomik nga vetë KPM-ja dhe me keqardhje më duhet të konstatoj se nuk ka pasur konsensus kur jemi marrë vesh se a duhet ta marrë mbi vete ministria hartimin e këtij ligji po, jo. Por esenca është që KPM-ja ishte dashur ta kishte fuqinë e hartimit të legjislacionit që i përket kompetencave të veta kushtetuese.

Gjatë gjithë procesit të hartimit të strategjisë, industria i ka dhënë propozime dhe vërejtjet e veta të cilat kryesisht nuk janë marrë parasysh. Po e njëjta gjë ka ndodhur edhe gjatë hartimit të projektligjit i cili është para jush sot. Si çështje që kërkon një vëmendje të veçantë për shkak të seriozitetit që ngërthejnë do të ndalem në këto dy pika.

E para, industria e ka ngritur te KPM-ja së paku tri herë çështjen e problemit shumë seriozedhe në këtë ligj, ... e Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave me atë të Komunikimeve elektronike.

Sipas situatës së krijuar pas aprovimit të Ligjit për komunikimet elektronike, një pjesë shumë e rëndësishme e kompetencave kushtetuese të KPM-së kanë kaluar te Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Kosovës. Sa për rikujtim e këtë e citoj edhe Anita

parëz, Komisioni i Pavarur i Mediave është kategori kushtetuese e sanksionuar me nenin 141 të Kushtetutës dhe e rregullon spektrin e frekuencave transmetuese në Republikën e Kosovës, i licencon transmetuesit publik dhe privat, i përcakton dhe i zbaton politikën e transmetimit ndër të tjera.

Sipas projektligjit, të cilin e keni para vetes sot, kompetencat e KPM-së reduktohen pak a shumë në një shërbim administrativ, teknik të ARKEP-it dhe përqendron mbikëqyrjen e përmbajtjes programore që bie ndesh me përshkrimin e nenit të lartë cekur të Kushtetutës. Këtë e keni në nenin 23 thotë “e mbikëqyrë përmbajtjen programore”.

Mbasi duhet përmendur se përderisa zgjedhja e anëtarëve të KPM-së bëhet nga Kuvendi me pjesëmarrje direkt të kandidatëve në konkurs, anëtarët e bordit të ARKEP-it zgjidhen nga Kuvendi në bazë të propozimit të Qeverisë pas marrjes së rekomandimit të ministrit përkatës.

Prandaj, edhe nuk jam tu paragjyku mund të ... çështja e politizimit eventual të bordit të Autoritetit siç quhet në këtë ligj. Unë jam ardhur në një situatë të një kolizionit politik, të një interesi politik i cili mund të shtyhet në proces. Edhe kjo çështje bëhet relevante te neni i shtojcës së ligjit, i cili i përkufizon anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës i përbërë nga 5 anëtarë, prej të cilëve një do të jetë nga ministria, 2 do të jenë nga ARKEP-i edhe dy do të jenë nga KPM-ja. E që ai komision do të kryesohet nga dikush i ministrisë.

Po i njëjti zbërthim vlen edhe për komisionin vlerësues të atyre që do të konkurrojnë në tender për t'i marr multipleksat dhe në të cilin i kemi të njëjtën përbërje, por dallimi është që kryesuesi i këtij komision do të jetë dikush nga radhët e KPM-së. Dhe, e gjithë kjo do të evitohej po qe se bartësit e procesit do të ishte KPM-ja prej fillimit deri në fund. Po këtu kemi ngatërrim kompetencash dhe do të kemi ngatërrim të institucioneve që do të merren me procesin deri në fund. Pika e dytë ka relevancë financiare dhe ekonomike. As në rastin e hartimit të strategjisë, e as me rastin e ndërtimit të këtij teksti ligjor nuk është bërë asnjë hulumtim i tregut.

Për pasojë, nuk është sqaruar as nga aspekti ekonomik, as financiar, e as të gjithë nëse Kosova është e gatshme për një proces të këtillë, pa marrë parasysh që është kërkuar që të mbërrihet data e 17 qershorit. Për më keq nuk është analizuar fare nëse ndryshimi i teknologjisë në drejtim të digjitalizimit do të jetë i qëndrueshëm dhe nëse po, sa do të jetë i qëndrueshëm, ata të cilët merren me teknologji e dinë shumë më mirë se unë se nëse vonohemi në proces, teknologjia mund të na shkel, edhe mund të vijmë në situatën të cilën e bëjmë një investim shumë të madh në digjitalizim e që mos të mund t'ia shohim hajrin mandej në fund as si publik e as transmetues të programeve.

Përfundimisht, ky ligj e ka edhe një mungesë të madhe e ky është implikimi buxhetor, të cilin shkarazi përmendet në dokumentin e strategjisë. Nëse e shikoni dokumentin e strategjisë përmendet një 4 milionsh atje. Se si ka ardhur deri te ai kalkulim unë nuk e di, por problemi është se po qe se Kosova do t'i hyjë këtij procesi edhe duhet ta ndihmojë popullatën me pajisje, ashtu që të sigurohet marrja e sinjalit të atyre që kanë për obligim ta informojnë publikun kush do ta mbulojë këtë investim. E as në procesin e ligjit e as në procesin e strategjisë nuk ka zbërthim të qartë se si dhe sa do të kushtojë komplet procesi i digjitalizimit në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Surroi! Fjalën e ka zoti Baton Haxhiu, nga KLAN Kosova.

BATON HAXHIU: Përshëndetje,

Unë jam Baton Haxhiu, faleminderit për ftesën edhe pse ftesa, mënyra se si është dërguar ka qenë me emra të përveçëm disa dhe të tjerët nëse keni kohë dhe për të ardhur këtu dhe për të shprehur brengat tona, mënyrën se si trajtohen ligjet, realisht edhe mënyrën se si e lexoi përfaqësuesja e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, shihet se ligji ka ardhur i kopjuar i 2008-es domethënë kur e ka pas fillimin në 2008-en dhe i aprovuar në 2013, me pak ndryshime.

Realisht çka synojmë me ligjin? Po i heq disa ose po e miratoj atë që zonja Flaka i tha vërejtjet e saja, të cilat i kanë substancën e vetë dhe janë shqetësuese, dhe do të ishin si të tilla më vlerësuese dhe të sakta sikur edhe KPM-ja si institucion i pavarur dhe kushtetues mos të bringoste të tjerët në garë, për faktin se me vite të tëra ka qenë institucion që ka monopolizuar situata dhe fakte.

Dhe natyrisht që nuk më erdhi mirë që ka kolizion brenda këtij ligji dhe ka kolizion që kush është kompetent më shumë për të ardhmen tonë. Ajo që mua po më vjen keq sot është se Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka prurë një ligj të cilin nuk e ka lexuar as vetë, dhe më vjen keq që ka ardhur këtu për të prezantuar diçka që nuk dinë çka prezanton. Ka fut në ligj emra të përveçëm që ligji nuk i duron, për arsye se jeta është dinamike. Dhe emrat e përveçëm janë në ligj, veç do të jesh totalisht analfabet për të kuptuar se emrat e përveçëm brenda një ligji nuk ekzistojnë kurrkund në botë.

E tjetra, që mua më shqetëson është se ju e keni bërë, e keni lexuar një projektligj në Parlament dhe e keni kaluar pa e vërejtur fare ose pa e lexuar fare dhe na e keni sjellë këtu me gjithë mundin që e kemi bërë për dy vjet për një strategji, të cilën nuk e keni lexuar fare. Si është e mundur? Që na sjellni një projektligj dhe një strategji që s'e keni lexuar fare. Na tregoni pse, dhe pse të gjitha atë mund tonin që e kemi bërë për vite nuk keni futur fjalë të cilat do t'ia lehtësonin edhe juve punën vetëm është dashur ta lexoni, asgjë më shumë.

Në vitin 2013, po na paraqiten gabimet, të cilat janë fundamentale që po na sjellin problem edhe neve në një garë ku do të jemi të barabartë edhe juve të cilët hartoni ligje. Ku e kemi problemin? Herën e kaluar në mënyrë brutale ta zëmë janë hequr dy nenet, ta zëmë të një ligji tjetër e të cilit po i vuajmë gjithë për shkak të shpifjeve dhe me fajin e vetë gazetarëve dhe protestave kanë hequr diçka që në një botë demokratike do të ishin të vendosura duke kërkuar fjalën e lirë, fjalën e lirë të cilën ne e keqpërdorim më së shumti duke përfshirë kolegët e mi dhe mediumet me të cilin brutalisht shkelim të drejtat dhe liritë e tjetrit.

Po ju them vetëm ajo që ka ndodhë në vitin 2013, të cilët është përsëritur edhe në këtë projektligj. Në vitin 2013, është vendi i vetëm në botë që frekuencat i ndanë brenda ligjit me vite, deri në vitin 2017 ju takojnë këtyre, po ju lexoj vetëm.... që ta keni të qartë se si është e mundur që ju nuk e keni lexuar këtu. Operatori i multipleksit duhet të sigurojë ... për fshirjen në multipleks të dy programeve të transmetimit publik të dy kanaleve historie, televizive, kombëtare KTV dhe RTV 21. Dhe dy programe rajonale televizive në çdo njërin nga pesë rajone të Kosovës, të cilat

kanë të drejtë të transmetojnë programet e tyre televizive duke shfrytëzuar teknologjitë e transmetimit digjital.

Më thoni, sot Afërdita edhe Flaka që janë udhëheqëse të KTV-së, janë shëndosh e mirë dhe kanë një projektim televiziv, po sikur të bankrotojnë nesër çfarë do të bëni me ligjin? Çfarë do të bëni me RTV 21 dhe KTV-në? Po RTK-ja që ka qenë ekzistuese me vite të tëra, s'është sot. Edhe e keni fut këtu RTK-në, çfarë do të bëni me emrat, ku kanë në ligj emra të përveçëm, këtë vajzën nuk ... a keni ju departament ligjor që i shikon këto gjëra. Këto janë elementare me projekte ligjore, emrat e përveçëm si me thënë LDK-ja është parti e përjetshme, si me thënë PDK-ja është parti e përjetshme, ku ka të përjetshëm nesër ikin edhe vjen një parti tjetër s'ekzistojnë më.

Ku ka brenda ligjit emra të përveçëm se nuk po ju kuptoj, qysh mundet 120 deputetë me thënë Baton Haxhiu brenda ligjit, edhe mos me vërejt, më thoni qysh dhe paramendojeni kur unë e shikoj me kujdes të ligj çfarë ligje kanë kaluar në këtë Kuvend e ju pa i vërejtur në mënyrë brutale gjërat të cilat nuk është dashur të ekzistojnë.

Dhe, krejt në fund unë do të sugjeroj që nuk kam ardhur tek e fundit le të jetë në ligj edhe KTV-ja, RTV 21 dhe RTK-ja, nuk më pengon se esenca është se çfarë serioziteti kemi ne ndaj ligjit, por kjo mënyrë në vitin 2013 është futur brutalisht brenda natës dhe ka mbetur pa u ndryshuar edhe sot kur po ndërtojmë një strategji e cila është krejt tjetër nga ato frekuenca dhe për dijeninë tuaj unë e di që nuk keni shumë dijeni në këtë proces, dhe secili prej nesh ka punuar më shumë dhe besoj Afërdita ka punuar më së shumti me procesin e digjitalizimit.

Por, aspekti financiar, mënyrën qysh na trajtoni, sa merrni ju përgjegjësi për këto sene. Besoj që pasojat nuk i keni vetëm ju, por edhe ne nëse nuk jemi të kujdesshëm se çfarë ligji po bëjmë. Ky Ligj i digjitalizimit në shumë vende të Evropës ka dështuar, ka dështuar për arsye se janë vonuar, për arsye se pajisjet të cilat teknologjikisht janë dal të reja i kanë vra pajisjet, të cilat më vonë janë shpërndarë. Mos na mundoni me gjërat, të cilat realisht nuk i njihni, nëse jo hajdeni se ka plot Ministria e Zhvillimit Ekonomik le të vijnë në zyret tona le të na pyesin, mos na thirrni veç këtu se marrin rrogë prej nesh e nuk vijnë, janë plotë aty edhe të institucioneve tjera le të vijnë dhe le të marrin shënime që le ta kenë idenë se për çka po flasim.

Mendoj që duhet të na merrni seriozisht se për dallim prej juve që në këto pika nuk na merrni, na ju marrim seriozisht në punën e juaj që përditë e bëni, dhe njëherë në jetë në çdo 4 vjet nëse e bëni një ligj merrnani më shumë seriozisht se kur fillojmë na mos me ju marrë seriozisht, atëherë nuk e di çka do të bëhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Haxhiu!

BATON HAXHIU:: Veç një sqarim po dua me dhënë të lutem, në qoftë se ka mundësi. Shikoni mendoj që na këtu sigurisht që duhet ta bëjmë diskutimin dhe duhet të jemi tolerant edhe kur dëgjojmë diçka që s'pajtohem, por sigurisht që deputetët e kanë lexuar ligjin, tash s'po muj me thënë por s'do me thënë që mendojnë krejt as deputetët njësoj të tërë, as që mendojnë deputetët siç mendojnë akterët e interesuar.

Prandaj, në vend të vlerësimeve edhe të cilësimeve t'i shtrojmë alternativat që janë më të mira zgjedhjet pa u mundu që dikë ta neglizhojmë ose kritikojmë por të shtrojmë atë që duhet të propozohet që është një alternativë që ne jemi të gatshëm me vëmendje me i trajtuar. Për këtë edhe ju kemi thirr Baton, për këtë ju kemi thirrë.

BATON HAXHIU: një pyetje e kam, më thuaj një ligj në botë ku ka emra të përveçëm?!

SADRI FERATI: Ka plot ligje në botë që ka emra të përveçëm.

BATON HAXHIU: Më thuaj një!

SADRI FERATI: S'kam nevojë me thënë se ka plot.

KRYESUESI: Më falni ju lutem, të mos, ju lutem Sadri. Ju lutem mos e merrni fjalën pa ua dhënë.

Para se gjithash zoti Haxhiu sa për njoftim projektligji ka kaluar vetëm në leximin e parë dhe në leximin e parë nuk ndryshohet asgjë prej tekstit i cili vjen prej sponzoruesit. Përderisa është kështu deputetët kanë mundur ta shohin, nëse eventualisht e shohin si gabim këtë edhe të mos mund të ndërhyjnë asgjë.

Gjatë kësaj faze edhe në fazën e amendamentitmit ka mundësi që kjo çështje të korrigjohet, ky grup punues jam shumë i sigurt se e ka vullnetin e madh që t'i përmirësoj gjërat që ky ligj të bëhet tamam ligj funksional që është në interesin e të gjitha palëve. Faleminderit!

Tani fjalën e ka zoti Migjen Kelmendi nga Rrokum.

MIGJEN KELMENDI: Faleminderit, për fjalën!

S'po di kah me ia nis se është një muhabet i gjatë 15 vjet, i cili kemi pas shpresë se në këtë proces të draftimit të një ligji me domethënie për të ardhmen e industrisë mediatike në Kosovë, kemi me pas mundësinë me tejkalu të gjitha ato probleme, që na kanë ndjek neve si akterë të këtij tregu e që janë gjeneruar nga një keqkuptim fundamental i përfaqësuesve të Komisionit të Pavarur për Media por në përgjithësi edhe institucioneve tjera që në një mënyrë a në një tjetër lidhen me punën e këtij komisioni e që këtij sipas keqkuptimi në Kosovë kemi një dorë televizionesh që janë diqysh si mbi ligj dhe i kemi do akter do gladiatorë tjerë që luftojnë në këtë treg tu u mundu me mbijetu këtë konkurrencë aspak legale aspak ligjore dhe në kundërshtim me të gjitha premisat e ligjeve pozitive në Kosovë që flasin për tregun e lirë, për konkurrencën e lirë, për barazinë para ligjit e ku ta di unë.

Kështu që po dua me thënë ku me kap këtu tregimin 15 vjet të vjetër, ku me marr pe marrim prej kreut, për me ju tregu se jemi tu i përjetu një situatë shumë të rëndë të një konkurrence aspak lejale duhet me ju thënë se për këtë ligj po ju them publikisht edhe para kamerave se as nuk na ka informuar askush, as nuk na ka ftuar askush, as nuk na u ka kërkuar një mendim e dëgjova që Ministria e përfaqësuesit po thonë që kanë marrë mendime të gjithkujt, pos të gladiatorëve të kësaj pune të cilët e mbajnë këtë peshë, kemi bërë investimet të cilat prekin domethënë interesat

tona, të cilat i marrim në atë rrezik të tregut, por që në një mënyrë po pengohemi prej njerëzve që as nuk kanë rrezik, as nuk kanë marrë përgjegjësi publike, as nuk kanë bërë investime dhe marrin guximin me fol për këtë hapësirë me një lehtësirë të padurueshme tu mos marrë mendimet e akterëve që në një mënyrë e mbajnë barrën e krejt këtij muhabeti të kësaj industrie.

Ndoshta kjo flet se si jemi tu u trajtuar në një mënyrë preferenciale një pjesë të tyre karshi pjesës tjetër, që po them burimin e ka një keqkuptimi fundamental, për të cilin unë e adresoj gjithmonë Komisionin e Pavarur të Mediave, të cilët e kanë një keqkuptim se dikush që transmeton me ajër është më i rëndësishëm se dikush që transmeton me kabull.

Në esencë digjitalizimi në Kosovë është kryes se vetë mundësia që u hap me transmetimin kabllor në Kosovë në një mënyrë ne e kemi bërë një digjitalizim të kësaj pune, kemi ngrit në njëfarë mënyre kualitetin, e kemi rritur hapësirën për me bërë televizion edhe me prodhuar lajme, por edhe sene tjera nganjëherë jo shumë të mira, por në parim e kemi kontribuar konkurrencës, zhvillimit të kësaj industrie po e quaj kështu kushtimisht dhe i kemi rritur mundësitë që ndoshta nesër të hyjnë edhe akterët e rinj në këtë hapësirë sepse kjo është hapësira, ky është treg tregu këtu vendos kush është televizion historik e kush është televizion a historik a ... ligji e ka një, më falni që po ju them, e ka një gabim që shpesh mundem me vlerësuar kështu but veç si qesharak se me quajt një televizion historik me ia dhënë vetes këtë të drejtë me e vlerësu, për mu është një gabim që unë s'po dua me ju akuzu po po them kjo gjenerohet prej një keqkuptimi 15 vjeçar në këtë vend

Unë e di se ai nocioni historik që e ka ligji në nenin 19, që është po them qesharak edhe po insistoj domethënë kështu kategorikisht që ju me u liru prej këtij kompleksi sepse as nuk e ka KPM-ja, as nuk e ka askush në dorë këtë punë e ka vetëm tregu i lirë dhe opinionin publik për me vlerësuar se kush është e çka është e tek është në këtë vend.

Komisioni e ka për detyrë për me rregullu këtë treg e jo me na kualifikuar, me na nda e me na diskriminu e me na bo e me na vlerësuar kush ku e ka vendin, duhet me qenë kriteret, të cilat në njëfarë mënyre na diferencojnë në kualitet dhe profesionalizëm po jo se kush është diçka e kush është diçka tjetër.

Termi “historik” sa e kam kuptuar unë nëpër legjislacione tjera e ka kuptimin e diçkaje që ka .. si Jugosllavia për shembull, domethënë unë mundem të ju propozoj juve përpiluesve të ligjit që termin “historik” me shkru edhe si televizione të vdekura, sepse “historik” i bie i vdekur në njëfarë mënyre. Por keqkuptimi te na është se na jena një popull që fjala “historik” ka shumë komentacione që flasin për trimëri, për dikush që është mbi historinë e do tjerë që janë historik dhe në një mënyrë e bëjnë qesharake këtë punë.

Unë e kam shpjeguar këtë edhe në simpoziumin që organizoi KPM-ja para një kohe ku ishin shumë akterë edhe ndërkombëtarë, por edhe të rajonit aty dhe në të njëjtin mënyrë të gjithë kanë qesh me këtë fjalë. Unë e kuptoj sepse ata nuk e kanë këtë konotacion që na ia japim fjalës “historik”, këtu është vetëm termi problem që unë po ju them shkruani televizionet e vdekura, KTV dhe 21 meqenëse i keni shti në televizione të vdekura në kuptimin e transmetimit analog. Prandaj, është fjala analog se po flasim për një transmetim.

Nuk janë të vdekura si në kuptimin e transmetimit digjital e kabllor por si transmetues analog na vetë po shkojmë drejt ditës kur kemi me vdes transmetimin analog në mënyrë ligjore, apo jo. Unë veç po dua me ju ndërtu kontekstin e fjalës “historik” sa i gabuar është me e përdor në ligj.

E keni shpjeguar edhe në strategji e keni shpjeguar, më duket që ka reflektuar KPM-ja, ... këta djemtë ligjor këtu, janë munduar me ma shpjegu se e kanë ligjet tjera, por nuk i kanë ata konotacionet e fjalës “historik” siç i kemi na këtu, ata e kanë shumë term teknik për mos me thënë i vdes, i mbarum, i krymë , i përfundum.

Kjo ke sa i takon idesë se ligji përmban diçka kaq qesharake si me quajt dikë historik në njëfarë mënyre kjo menjëherë bie ndesh me shumë ligje që flasin për barazi, mos të hyjmë në këtë analizë të kësaj.

Çështja tjetër është që procesi i digjitalizimit kemi prit se do t’i jap fund po them kësaj politike preferenciale që i ka kultivuar Komisioni i Pavarur për Media gati 15 vjet ndaj tre akterëve të kësaj lëmie. Këta janë RTK, KTV dhe RTV 21.

Këta e kanë një keqkuptim fundamental se këto televizione kanë diçka që s’kanë këta tjerët. Në parim është një diçka që është dokumentuar me qindra herë, nuk kanë argumente me ballafaquar as me një vlerësim tonin me për këtë çështje, asnjë se kanë, por pse vazhdohet me këtë preferencialitet ndaj disa akterëve të tregut medial unë këtë s’po muj me kuptu dhe jam shumë i çuditur si ka mundur ky preferencialitet, kjo qasje asimetrike ndaj akterëve të tregut me u përfshi në Ligjin për digjitalizimin i cili në esencë ka qenë dashur me krijuar kushte të barabarta për të gjithë akterët e kësaj lëmie.

Tu mos e nënçmuar askënd, por jo tu i diskriminuar dikë edhe kam nis me u përsërit me këtë çështje diskriminim sepse 100 herë po e flasim po s’po reflekton komisioni, çka kemi me bë. Unë e kam detyrë me e përsëritë sa herë që muj.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kelmendi!

MIGJEN KELMENDI: Nuk e kryva më falni veç edhe një minutë edhe e përfundoj.... ku e pata fjalën në këtë çështje, ne do t’i deponojmë në formën e shkruar disa nga vërejtjet që i kemi pa në këtë ligj. U pa shumëçka aty është e çuditshme qysh domethënë akterët tjerë nuk e shohin elefantin në ligj, u panë shumë gabime në ligj por nuk u pa elefanti në ligj që ligji në një mënyrë ka qasje asimetrike ndaj akterëve të tregut dhe këtë e vërteton neni 1, neni 19 në pikën 1 dhe e vërteton ideja që ligjin e përfshin një diçka që quhet “televizionet historike të Kosovës”.

Çka domethënë “televizione historike” ? ky nen kjo pikë duhet me u fshi, se është alogjike, është diskriminuese dhe na bën të barabartë krejt neve gladiatorët e kësaj pune para ligjit. Te çështja e digjitalizimit ka shumë aspekte teknike që unë po besoj se organizata përkatëse dhe ministria duhet me iu qas në një formë shumë me përgjegjësi, sepse koha po kalon, por është edhe një çështje tjetër me potencu se në strategjinë për digjitalizim shumëçka na e kemi deri diku e kemi akorduar ose si me thënë e kemi prur te një pajtim i durueshëm, i zorshëm por i durueshëm.

Dhe një kolizion midis strategjisë dhe ligjit ekziston është ekzistent, shihet që shumë çështje që i kemi tejkalu se po më duket edhe mu që po përsëritna se i kemi fol 100 herë po duhet me i thënë

prapë sepse ligji nuk i ka marrë parasysh shumë pika që strategjia pak a shumë i ka zgjidh në një mënyrë për mu... jo shumë të mirë, por të durueshme sa me mujt me vazhdu masandej përmes ligjit me i barazu edhe me i hekuros ato keqkuptime që munden me lind prej neneve dhe formulimeve.

Edhe njëherë po them, krejt ideja po them që Kosovës i duhet një treg më në fund virulent, konkurrentë me akterët që marrin përgjegjësinë për atë që bëjnë, ku Komisioni i Pavarur për Media e ka vetëm një rol të rregullatorit të kësaj gare ku opinionin vërteton kush është historik e kush është ahistorik në këtë vend... se antinomi historik ... është kundërhistorik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

MIGJEN KELMENDI: Mos të flas për nacional, se ato janë qesharake. Domethënë, ka pas po më shtynë me u përsëritë, se ne i kemi folur 100 herë, ka formulime qesharake në formulimet e ligjeve, që i bën KPM-ja, shih sa mirë edhe vetë po qesh me këtë punë, se po them, për të qeshur është kjo.

KRYESUESI: Zoti Kelmendi, faleminderit!

Tani fjalën e ka zonja Afërdita Kelmendi nga përfaqësueset e 21-shit të Ampekut.

AFËRDITA KELMENDI: Fillimisht, nuk do të merrem me asnjë çështje dhe as me apostrofimin e Televizionit tim, për shkak se kjo është bërë një tregim i përçudshëm me vite të tëra, në kuadër të çdo tubimi në të cilin diskutohet për medie.

Në fund të ditës është e vërtetë se jemi në treg dhe ne në këtë treg garojmë dhe garojmë me atë që kemi. Prandaj, ai që vlerëson nuk është as kjo sallë, nuk është as unë, as ndonjëri tjetër këtu, po është shikuesi, i cili vlerëson, përcakton dhe ndërron kanalin dhe të dobëson ose të forcon.

Prandaj, nuk kemi çka diskutojmë lidhur me këtë çështje.

Sa i përket çështjes së ligjit, më në fund o ta marrim vesh, nuk është duke ndodhur kurrëgjë tjetër, përveç një ndryshimi teknologjik dhe teknik! Ne jemi ata njerëz, që do të vazhdojmë të prodhojmë. Po ndryshon teknologjia. Për shkak të ndryshimit teknologjik jemi në gjendje prej një frekuence të bëjmë ndarjen e atillë, ku do të mundësohet që të hyjnë më shumë kanale. Kush është humbësi këtu, kush është fituesi këtu?

S'ka humbës, po s'ka as të fituar! Se, në fund të ditës, për t'i hipur në platformë ato kanale do duhet të prodhojnë prodhuesit. Ne në kuadër, jo të këtij ligji, për shkak se kjo nuk përcaktohet me ligj, po mund të jetë edhe një nen atje, ku duhet prodhuesve tu sigurohet treg. Domethënë, KPM-ja, edhe njëherë e kam thënë dhe, po e them përsëri, se këta dy kolegët e mi që po mbrojnë përgjakshëm veten, si gladiatorë, mund tu them, se unë i kam pesë kanale gladiatore, në kuadër të platformave, në të cilën transmetojnë edhe ata. Dhe, asnjëherë nuk kam qenë kundër asaj, që kanalet kabllorë të trajtohen barabarësisht për shkak se në fund të ditës, janë prodhues.

Edhe nëse e zbërthejmë këtë ekonomisht, ju zoti Mustafa e dini çfarë do të thotë, është investim. Dhe, nëse këta njerëz investojnë, nëse unë investoj, nëse kolegët e mi, të cilët luftojnë

në këtë treg të vogël, të papërshtatshëm, ta pamonitoruar, të parregulluar, dhe mbijetojnë – bravo u qoftë! Duhet me ua shtri dorën!

Me çka ky ligj mbron këto medie? Me çka ky ligj mbron, qoftë kanalet historike, për të cilat nuk e kemi shpikur termin ne, po e ka shpikur Evropa dhe çdo shtet perëndimor e ka pasur në kuadër të Ligjit për digjitalizim nocionin kanali historik. Prandaj, nuk kam çka hy në atë çështje.

Këtu historia e Kosovës është e dhembshme, historia e zhvillimit është e dhembshme, prandaj edhe unë mund ta kuptoj deri diku edhe dhimbjen e Migjenit, kur thotë, pse kjo e pse jo unë? Po, jo këtu nuk ka pse kjo, pse jo unë. Çohuni burra, punoni, arrini!

Patjetër duhet të krijohen mundësit, mirëpo ato mundësi duhet krijuar dhe me i garantua ligji. Edhe për këto kanale, për të cilat sot po protestojmë, po edhe për ne që po protestojmë, prej fillimit, me vite të tëra për çështje ligjore, të cilat nuk janë rregulluar si duhet. Edhe në këtë rrafsh nuk është i rregulluar si duhet licencimi, në kuptimin që kur të licencohet një medie me kabllo, se për licencimin frekuencor e dimë se s'ka pasur frekuenca. Por, në kabllo kur të licencohet, duhet t'i sigurohet autostrada, ti po ma shet kerrin e s'po ma bën rrugën me hip në të. Qe qikjo është njësoj edhe me digjitalizimin.

Nëse janë të gjitha këto kanale të licencuara, këta duhet të kenë autostradë ku do të hipin. Këta duhet t'i hypin kerrit, tash a ka fiqë, a ka mercedes, a çka e ka, s'është me rëndësi, ti e ke licencu, ja ke marrë paratë. Edhe në treg, kur t'ia marrësh paratë ti duhesh me ia krijua kushtet.

KPM-ja në këtë rast përkatësisht edhe ligji, nuk i siguron këto çështje, që atëherë ne të gjithë në mënyrë të jemi të barabartë dhe, unë pajtohem që duhet të jemi të barabartë në treg e pastaj, ajo çka shesim përcakton kush është më i madh e kush është më i vogël.

Mirëpo, barabarësia në treg patjetër duhet të jetë. E barabarësia krijohet, kur të gjithë të licencuarit, konform licencave që kanë, se mos harroni, që licencat nacionale televizive në spektrin analog deri tash kanë paguar taksa shumë të mëdha, tatime të mëdha, të cilat televizioni kabllor, që unë i kam pesë, nuk i paguan. Nuk i paguan, se përderisa ne si kompani televizive paguajmë 0,1% të qarkullimit vjetor të televizionit si para KPM-së, përkatësisht buxhetit të shtetit, për pagesa e televizionit kabllor është 1800 euro vjetorja.

Edhe këtu ka dallime shumë të mëdha. Prandaj, nuk mund të flasim përmendësh, jo këta me të drejtë, këta pa të drejtë. Urdhëroni, forcohuni, punoni, krijoni kushtet, kurrkush s'ua merr të drejtën të çelni kësi ose asi. Tregu përcakton përsëri në fund të ditës.

Ajo që mua më brengos më së shumti realisht, është që po futemi me një shpejtësi të madhe në një proces, të cilin as nuk e njohim, as nuk e kemi hulumtuar. Pse po them nuk e njohim? Ne disa e njohim shumë mirë. Edhe duke e studiuar me vite të tëra, ne po shohim çka po ndodhë në Bashkimin Evropian. Në Bashkimin Evropian projektet më të mëdha televizive po dalin nga projekti i digjitalizimit. Po dalin jashtë. Është shumë i shtrenjtë. Nuk është veç i shtrenjtë për ta bërë, është shumë i shtrenjtë për ta mirëmbajtur, është shumë shtrenjtë për tu shitur.

Domethënë, do t'ua jap vetëm një shembull shumë plastik në Rajon, i pari që ka bërë digjitalizimin dhe i cili ka tenderuar është Maqedonia. Në Maqedoni një operator i vetëm i ka fituar të gjitha frekuencat. Operatori One, që është IPKO-ja jonë këtu. Ai operator, a mund ta merrni me mend, edhe aty më nuk është me rëndësi a jam unë televizion nacional, a je ti televizion kabllor a çka je, a i ke paratë, ke me hip në platformë.

20000 euro në muaj kushton me i hipë asaj platforme digjitale. 70% e tregut televiziv në Maqedoni shkon në platforma kabllore, asnjë televizion, qoftë edhe nacional nuk duan të shkojnë në platformën digjitale, se po i sakaton. Pse me i dhënë 200 e sa mijë euro në vjet, kur i jep 1000 euro në vjet edhe hip edhe me kablo je i shpërndarë në të gjitha anët.

Asnjë analizë e këtillë në Kosovë lidhur me këto çështje nuk është bërë. Pse duhet unë, si televizion 21, ose KTV, ose qoftë edhe Klan-Kosova apo RTK apo Rrokum, pse duhet me hy në investime, të cilat kushtojnë marramendëse, unë do tu jap në mënyrë plastike sa kushton një transmetues.

Transmetuesi më i lirë kushton diku deri në 20000, veç ajo kutia, më i liri. Ndërkohë, që nëse do të marrësh transmetues të mirë, që ta bëjë mbulueshmërinë e s'ka me u djegë llambat e ato qarqet e si u thonë, atëherë duhet të shkosh ta blesh 50000 euro në minimum. Mos të flas për antenat, të cilat kushtojnë 20 – 30 mijë euro ekstra. Mos të flas për linçet, e di shumë mirë Ekremi sa kushtojnë linçet. Pastaj, mos të flas për shpenzimet mbi të gjitha shpenzimet të cilat duhet të bëhen.

I gjithë procesi, jo shtetin, shteti ka me i pagua sa? Hajde, ka me i pagua qata recivera për shikuesit e vetë, për shikues të cilët s'paskan para për të ble, ose do të duhet me u ndërrua televizorët. Le të shkojnë qaty nja... sa mund të shkojnë?... 4 milionë, 5 milionë... A ka menduar shteti për industrinë prodhuese të Kosovës, që janë televizionet? Sa do të falimentojmë në këtë proces? A e ka menduar? Nuk e ka menduar. As që i është bërë vonë.

Komisionit Evropian nuk i bëhet vonë për këtë punë, se ata manipulojnë në Evropë me para të madhe. Ndërkaq, Kosova nuk i ka paratë e duhet të hyjë në një proces shumë të shtrenjtë. Pse duhet ta bëjmë ne këtë? Pse duhet ta bëjmë? Ne s'kemi nevojë ta bëjmë fare. Ne mund t'i hyjmë, ta bëjmë një ligj, i cili do të përcaktojë kush do të udhëheqë procesin.

Komisioni Evropian nuk ka caktuar datën e fundit 17 qershorin. Ju lutem, kush ua ka futur në kokë që 17 qershori është data e fundit për digjitalizim? Nuk është e vërtetë!

Komisioni Evropian thotë, kush është gati duhet të hyjë në procesin e digjitalizimit, kush nuk është gati duhet të përgatitet, por kjo nuk nënkupton që ne duhet t'i hyjmë këtij procesi. Edhe nuk ke... ky vend është para kollapsit ekonomik edhe duhet të hyjmë në shpenzime, të cilat as Komisioni Evropian as IPA fondet, IPA fondet janë të zbrazëta më për këtë, nuk janë duke investuar, as IPA fondet. IPA fondet i morën vendet e mëdha. Ne as që i kemi kërkuar ato fonde për digjitalizim për në Kosovë, as që i kemi kërkuar.

Dhe, ju zotërinj deputetë, duhet të pyesni, pse s'janë kërkuar IPA fondet për digjitalizim të këtij vendi, i cili nuk është shumë i madh, është i vogël. Është i vogël edhe Evropa kishte me mujt me

e përballu, pse duhet ta përballojmë edhe ne si medie. Nëse ti futesh në këtë proces, më falni që po ju mbaj një ligjëratë, po kjo ligjëratë është vërtet duhet të jetë edukative për të gjithë ne, në kuptimin ta kuptojmë çka po na... ku po na çon ky proces.

Dhe, unë do t'ua jap elementin e fundit që do të ju bind çfarë po ndodhë në Evropë.

Në Evropë më datë 5 maj në jug të Francës IBU-ja bashkë me shoqatën më të madhe telekomunikuese, me ARKEP-in e Evropës, kanë mbajtur një konferencë në të cilën është diskutuar çështja e 5G-së. 5G më s'ka për të njohur as digjitalizim as kurrëgjë tjetër. Ne jemi duke hyrë në fazën e 5g-së. Si Evropë domethënë, po diskutohet edhe po thuhet, që brenda 5 vjetësh do të dalë domethënë kjo teknologji në treg edhe do të fillojë të shfrytëzohet.

Pse, more burra, duhet na me mendu tash nja 20 – 30 milionë me i investua në një proces, ku do të blejnë pajisje prej shitësve të mëdhenj të pajisjeve e pas pesë vjetësh do të duhet prapë t'i blejmë ato tjerat përsëri prej qatyre shitësve të mëdhenj. E ne jemi shumë të vegjël për të ble nga dy-tri herë. Evropa ka para, ne nuk kemi.

Prandaj, në kuadër të këtij procesi, ta miratojmë një ligj, i cili thotë që ne si vend do t'i futemi procesit të digjitalizimit, e kemi një strategji në bazë të së cilës do të punojmë, por procesi në Kosovë nuk do të mund të shkojë aq shpejt, për shkak se s'ka para, nuk jemi të zhvilluar, nuk jemi të pranuar. Ne duhet edhe kushte të qesim, s'jemi të pranuar ne. Prej kujt jemi të pranuar ne, që duhet ta pranojmë një proces të cilit s'mund t'ia dalim në krye.

Prandaj, nëse do të veprojmë kështu, do t'u japim mundësi të gjithëve që të zhvillohen edhe ta presim pak teknologjinë, të shohim kah po shkon. Mos të hyjmë kryeshtas në një proces, të cilin do të na dalë “kapuç me mëngë”. Faleminderit për durimin!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Kelmendi! Kush e do fjalën tjetër?
Zoti Mentor Shala nga RTK.

MUHAMET MUSTAFA: Ju lutem,
Sot nuk kemi nevojë të bëjmë shumë polemizime apo polemika. Prej organeve, prej institucioneve shtetërore edhe rregullatorë, për arsye se ata do të jenë grup punues dhe atje do t'i ballafaqojnë mendimet edhe KPM-ja me ART-në dhe ministrinë e me komisionin. Në fund, Parlamenti vendos. As s'vendos ministria, as s'vendos KPM-ja, as s'vendos ART-ja, në fund ne i kemi dëgjuar dhe për ata po duam t'i dëgjojmë të gjithë përfaqësuesit e medieve, t'i dëgjojmë mirë, se ne e kemi lexuar ligjin, po siç tha Batoni, nuk e lexojmë të gjithë njëjtë edhe s'e kuptojmë të gjithë njësoj, po edhe kur ju dëgjojmë juve e pasurojmë kuptimin tonë të ligjit.

Domethënë, është një punë me shumë përgjegjësi, që po tentojmë ta bëjmë, prandaj më së shumti jemi të interesuar t'i dëgjojmë aktorët e interesuar, prodhuesit siç u përmend disa herë këtu. Urdhëro!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Mustafa!
Zoti Mentor Shala, vazhdoni ju lutem!

MENTOR SHALA: Faleminderit!

Të them të drejtën, mua nuk më mbeti të them diçka, se u thanë shumica e gjërave, u thanë edhe në fakt pajtohem edhe si RTK edhe personalisht me shumicën e vërejtjeve që u dhanë nga pothuajse të gjithë parafolësit.

Mund të them, se kemi qenë edhe si RTK prej fillimit pjesë e procesit, e këtyre proceseve që kanë ndodhur për digjitalizimin dhe që në start edhe prej startit e deri më tash, vazhdimisht është përcjellë me paqartësi.

Mendoj se ka pasur një moskoordinim në mes institucioneve, të cilat është dashur të merren me këtë çështje. Vetë fakti që e kemi një strategji dhe e kemi një ligj, të dyja janë në Kuvend për shqyrtim, domethënë njëherë është punuar në ligj, në strategji në fakt,

(Debat nga pjesëmarrësit.)

... Më fal, a bën ta përfundoj, e pastaj i jepni... po mirë de, e thoni pastaj, pasi që ta kryej unë, nëse ka mundësi!

Janë dy procese në të njëjtën kohë, domethënë e kemi shtjelluar me një strategji para disa vjetësh, para pesë-gjashtë vjetësh, tash s'po di saktë t'i numëroj, dhe pastaj është filluar një proces, i cili është ndalur për një kohë të gjatë, me vite të tëra nuk është punuar në të. Është filluar me ligjin shpejt e shpejt, sa për të thënë që nga Ministria e Ekonomisë, sa për të thënë që po bëjmë një ligj.

Dhe në fakt, pastaj në të njëjtën kohë është vazhduar me të dy proceset paralelisht. Dhe tash e kemi një strategji, në të cilën është punuar qe disa herë, edhe pse prapë konsideroj që edhe në atë strategji ka mangësi dhe të cilat, domethënë nuk ka pasur ndonjë ekspertizë të mirëfilltë në hartimin e asaj strategjie. Po, megjithatë është punuar një strategji, është mbajtur një dëgjim publik, jo më shumë.

Domethënë, ka munguar, sipas mendimit tim, kanë munguar grupet punuese, që është dashur gjithsesi që të formohen me të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces, grupe punuese që do të ulëshin edhe do ta hartonin e ta gjenin një kompromis për hartimin e një strategjie, në bazë të së cilës do të hartohet ligji.

Tash e kemi një situatë konfuze. Normalisht, ne si RTK edhe ne i kemi vërejtjet tona. I kemi dërguar në Ministrinë e Ekonomisë në kohën kur ka qenë në diskutim çështja e draft-ligjit, nuk janë marrë parasysh. Janë marrë parasysh diku nja 10%, jo më shumë, njëjtë sikurse edhe në strategji. Domethënë, si RTK i kemi vërejtjet tona.

Normalisht, që ne si RTK e kemi një status pak më ndryshe se privat, për shkak se jemi transmetues publik edhe e kemi një themelues dhe një ligj, në bazë të të cilit funksionojmë. Por, megjithatë ka në bazë të praktikave, ka praktika shumë të mira në vende, të cilat i kanë përfunduar këto procese e të cilat do të ishin shumë të rëndësishme dhe do t'i përshtateshin ambientit dhe rrethanave në Kosovë edhe të transmetuesit publik.

Ne i kemi vërejtjet tona, sigurisht, tash pasi që s'i përmendi kurrkush vërejtjet më konkrete, as ne s'po i përmendim, por i dërgojmë në e-mail ose sido që... janë format tjera, do t'i dërgojmë edhe shpresojmë që, prapë është një propozim imi që të formohet një grup punues për këtë çështje, me të gjithë aktorët dhe të punohet më konkretisht, pak më seriozisht se që është punuar deri më tash. Deri më tash, s'ka pasur qasje serioze ndaj kësaj çështjeje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani për një moment do t'ia jap fjalën deputetes Shqipe Pantina. Përpikuni të mos e zgjasni shumë, ju lutem!

SHQIPE PANTINA: Atëherë s'po dua ta marr fjalën shumë shkurt.

E para, krejt çka kuptova është që në fakt Ministria e Zhvillimit Ekonomik nuk i ka konsultuar palët.

Të paktën, ky ishte shqetësimi që unë e mora, nëse e kam gabim, ju lutem më konsultoni.

Mentor, strategjia është dokument i KPM-së, nuk ka ardhur asnjëherë në Kuvend për miratim. Ai ka shkuar në Qeveri, se Batoni na kritikoi, që deputetët s'e kanë lexuar, ka edhe të tillë ndoshta që s'e kanë lexuar, kështu që t'i sqarojmë se çka, dokument i kujt është dhe detyrë e kujt është.

Është krijuar grupi punues dhe ne jemi grupi punues, që po ju dëgjojmë. Kështu që, nuk besoj se do të ketë ndonjë grup punues tjetër, se vërejtjet, në fakt më dëshirë do të dëgjoja vërejtjet në nene të caktuara dhe si do të mund të rihartoheshin... po, nëse i leni me shkrim, ju falënderoj shumë, sepse të paktën grupi punues ne duhet t'i hartojmë një nga një.

Ne i kemi marrë edhe më herët, aq sa kemi mundur, të paktën po flas për subjektin tim si Lëvizje, përveç që i kemi konsultuar edhe ekspertët tanë të brendshëm edhe jemi mundur edhe në leximin e parë edhe pse, në leximin e parë është pak e kufizuar për të dhënë vërejtjet në detaje, por të paktën përgjegjësi. I kemi parë edhe ne mangësitë, që i ka ligji dhe aq sa kemi mundur t'i konsultojmë, i kemi konsultuar edhe aktorët tjerë, ndoshta jo industrinë në mënyrë individuale, por të paktën, institucionet që i përfaqësojnë.

Tash, po është mirë t'i dëgjojmë ndoshta secilin medium veç e veç, por për ne është më me rëndësi, që ai që flet në emër të të gjithë mediumeve, që po shpresoj se ju e keni organizatën përfaqësuese.

Po, unë kam edhe një shqetësim tjetër. Po ashtu, duke cilësuar veten amatore në këtë fushë, çka do të ndodhë me transmetimet që jepen vetëm on-line? Ka plotë mediume, nëse mund t'i quajmë mediume, që përveç që japin lajm të shkruar japin edhe lajm vizual me video on-line. Tash, çka do të ndodhë me ato?

(Ndërhyrje: Ka ligj për multi-medie, i veçantë.)

... e po tash, ato a digjitalizohen a nuk digjitalizohen, apo çka ndodhë me këto çështje?!

Prandaj po them, kur po flitet, ose e ngushtojmë diskutimin vetëm... sepse, sot doli pak diskutimi prej çështjes së digjitalizimit, ose nëse hapim debat për medie, që unë besoj se duhet hapur një debat më i gjerë për funksionimin e medieve dhe mënyrën, qoftë të vetë rregullimit të medieve, qoftë të rregullimit përmes legjislacionit, unë mendoj që duhet hapur një debat më i gjerë se ky. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Pantina.

Fjalën e ka, ju, ju lutem, s'po ua di emrin, më falni.

Ju lutem, prezantohuni së pari.

VISAR HALIMI: Unë jam Visar Halimi, shef i departamentit të menaxhimit të frekuencave në kuadër të ARKEP-it.

Me anën e Ligjit tonë të komunikimeve elektronike, kemi natyrisht, mjaftë kompetenca për menaxhimin e spektrit frekuencor, pothuajse 95% ndoshta, të gjithë spektrit frekuencor.

Çështja e shërbimeve radio-difuzive broad-casting është e rregulluar mjaftë mirë edhe me Ligjin e KPM-së. Edhe në këtë ligj mendoj se, sa i përket raportit KPM dhe ARKEP shumë pak ka divergjencë, shumë lehtë mund t'i tejkalojmë këto dhe aspak nuk kemi ndonjë shqetësim, që ne dëshirojmë t'i marrim kompetencat, ose diçka tjetër.

Në 90% të ligjit KPM-ja e ka autoritetin e vet për këtë çështje. Janë disa çështje me të cilat zhvillimet, siç i përmendi edhe kolegja Kelmendi, që mund të ndodhin në të ardhmen, shërbime të reja e gjëra të reja, të cilat ARKEP-i duhet të jetë prezent gjithsesi, siç është puna e dividendës digjitale, siç janë punkta e dividendës së parë dhe të dytë digjitale, që po ec aq shpejt Evropa dhe që unë personalisht i kam qitur në paragrafë të caktuar, për shembull.

Sa u përket kompetencave të KPM-së dhe daljes së ARKEP-it në më shumë kompetenca, ju siguroj me plotë kuptimin e fjalës, se as ARKEP-i nuk është i interesuar të marrë aq shumë kompetenca, që nuk i takojnë me ligje e gjëra të tjera, por edhe me këtë ligj. Dhe, besoj që shumë lehtë do ta tejkalojmë.

Po supozojmë, në paragrafin 4, të gjitha këto gjëra tjera i kemi thënë që plani për shfrytëzimin e radio-frekuencave, kanë thënë, do të përgatitet nga KPM-ja. Ne gjithmonë e kemi përgatitur. I kanë dhënë kompetencë, po ne e kemi bërë një korrigjim, veç një fjalë duhet. "Plani për shfrytëzimin e radio-frekuencave, për shërbime radio-difuzive do të rregullohet nga KPM-ja, të gjitha të tjerat do të rregullohen nga ne." U krye ky amendamentim.

Ose diçka tjetër, thotë: "... ndryshimi i licencimeve. Autoriteti do të ndryshojë vendimin për ndarjen e frekuencave...", "KPM-ja do të ndryshojë, Autoriteti do ta mbështesë.", u krye. Një nen shumë lehtë i korrigjueshëm.

Prandaj, po dua të them që një çështje na mbetet, që duhet t'i potencojmë edhe dividendat dhe po ashtu edhe kanalin e 58-të. Pse duhet ARKEP-i të jetë një nga personat në komisione? Sepse, edhe kanali 58 në të ardhmen, brenda një afati shumë të shkurtër, pesëvjeçar, do të jetë pjesë e dividendës 2, që tashmë Evropa ka marrë.... vendime me u dhënë shërbimet mobile në këtë brez,

kurse kanali 58... veç kush do të jetë ai që do të investojë për një afat pesëvjeçarë për kanalin 58. Në aspektin e përgatitjes së dokumentacionit duhet me pas kujdes në këtë pikë, prandaj edhe te çështja e komisionit ku u përmend ARKEP-i 2, K-2. Ne si ARKP, mendoj se neve na duhen 2 njerëz me i pas, qoftë në aspektin legjislativ dhe teknik, sepse ka me pas materiale me i shqyrtuar. E a i duhen KPM-së 3, 4 a 6 le të vendosin këta, por në aspektin tonë të ARKEP-it na duhen 2 njerëz. Nëse mendoni që s'ka nevojë, nuk ka problem.

Ky ligj po më duket 2.2.1 është shumë, për neve nuk prishë. Përmbajtja e dhënies së resurseve frekuencore varet në përmbajtje, jo në komision. Domethënë, strukturën e përmbajtjes si do ta trajtojmë atë, jo diskriminuese, me kushte të mira teknike. Kjo është përmbajtja, e a do të jenë 5 a 7 ma merr mendja se shumë relevante është. Faleminderit! Prandaj, ne i kemi bërë vërejtjet, nuk janë shumë, janë shumë pak 4, 5 nene me nga dy fjalë, tri fjalë, por që e ndërtojnë dhe e rregullojnë mosndërhyrjen mbi ligjin në ligjin tjetër. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit zoti Halimi. Tash, e keni fjalën ju, atje!

VISAR HOTI: Jam Visar Hoti, nga Televizioni Tema dhe i përfaqësoj mediat lokale rajonale të Kosovës.

Ne si AMPEK kemi qenë të involvuar në dëgjimet e para në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe në Grupin Punues sa i përket këtij ligji dhe që nga atëherë i kemi dërguar vërejtjet tona të cilat në shumtën e rasteve nuk janë marrë parasysh nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik.

I kemi dërguar ato dhe kanë ardhur komentet nga ekspertja e Komisionit Evropian, nga zonja slovene e cila i ka kthyer mbrapsht të gjitha komentet tona, duke mos marrë parasysh direktivat e Komisionit Evropian vetë ajo, një pjesë të direktivave të Komisionit Evropian që flet për analizën e tregut.

Ka qenë vërejtje e AMPEK-ut edhe në strategjinë për digjitalizim po edhe tek ligji, që sipas direktivës 2002/21 të Komisionit Evropian paraprakisht kërkohet analizë e thukhtë e tregut ex-ante që duhet rregullatori ta publikojë dhe publikojë emrat e ndërmarrjeve me fuqi të ndjeshme me treg, para se t'i hyjmë rimodelimit të tregut.

Ky dokument mungon, ka munguar në strategji, mungon edhe tani. Pra, hyjmë në një zonë të errët pa ditur se ku po përfundojmë në aspektin e krijimit të monopoleve apo mbrojtjes nga monopolet. Ky është problemi i parë.

Çështja e dytë është që në këtë Komision kur na kanë thirrur këtu për zhvillim ekonomik, nuk e kemi potencuar deri tash rrezikun dhe problemet që ky ligj i krijon në aspektin e shkatërrimit të infrastrukturës ekzistuese transmetuese.

Është parim në Evropë dhe parim edhe në udhërrëfyesit e ITU dhe në udhëzuesit e Komisionit Evropian që te infrastruktura ekzistuese sa më shumë të inkadrohet në transmetimet digjitale, që kjo nuk është e garantuar me këtë ligj.

Pra, automatikisht çfarë mesazhi mund t'i sjellim ne investitorëve të huaj nëse i bëjmë dëm industrisë aktuale mediave në Kosovë me 7, 8 milionë euro, nëse e dëmtojmë industrinë, nëse të gjithë që jemi tani në menaxhim të frekuencës të na hiqet e drejta e transmetimit dhe i jepet dikujt tjetër. Çka do t'i bëjmë ne asaj infrastrukture? Ku është dëmi që po krijon ky ligj?

Këto analiza mungojnë para se të procedohet më tutje.

Tjetër. Kemi problemin që e kemi shfaqur edhe mediat lokale, edhe rajonale te puna edhe e strategjisë dhe se ky ligj nuk garanton në formë afatgjate transmetimin lokal dhe rajonal, e as përfshirjen e infrastrukturës së tyre në digjitalizim.

Kjo është një brengë e madhe edhe për rajonet e Kosovës, është brengë e madhe edhe për bashkësinë ndërkombëtare. Edhe zonja nga Ministria e Zhvillimit ekonomik e din brengën ndërkombëtare që është shfaqur në zyrën e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, por nuk e ka potencuar këtu, sidomos të palës amerikane, për këtë çështje, mu për këtë draftligj.

Dhe, nuk po i thekson arsyet pse janë ndalë, pse ky ligj është ndalë qe 2 vjet, pse nuk ka vazhduar më tutje. Duhet të jemi transparentë dhe të hapur dhe t'i flasim gjërat ashtu siç janë.

Pra, ka pasur nevojë për rregullimin e mëtutjeshëm të këtij drafti në mënyrë që të vjen dhe kalojë në Qeveri, dhe të vjen në leximin e parë në Parlament. Pra, nuk janë bërë rregullimet e duhura që ky ligj të jetë i pranueshëm. Prandaj, duhet punë serioze, që qytetarët e Kosovës ta shohin përfitimin e këtij procesi, industria aktuale, po edhe investitorët e ri, mediat e reja që vijnë, të shohin dhe të gjejnë një kompromis shoqëror që e kemi dhe ky ligj do të duhej të reflektonte. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti Hoti! Tani e ka fjalën Spahiu, TV Mitrovica!

NEXHMEDIN SPAHIU: Ju faleminderit!

Unë për të ju kursyer kohën, vetëm për disa çështje, që mendoj janë me rëndësi. Te kjo pika 19 kur thotë maskare, operatori i multipleksit duhet të sigurojë multipleks te programet, dhe po e kapërcej këtë, po vi deri te kjo TC.

Dhe dy programe rajonal televizive në çdonjërin nga 5 rajone të Kosovës. Tani, këto televizionet e vdekura, po mendoj edhe si historike, janë 20 gjithsej, domethënë me nacionale, rajonale dhe lokale.

Në regjionin e Mitrovicës janë 3. Në Ferizaj janë, me serbisht, dhe Shtërpca ku i bjen, Gjilan e tjera. Tani qysh do të përcaktohet do të thotë cili do të shkojë në dy prej këtyre tri, ta zëmë për regjion të Mitrovicës po flasim. Do të thotë kush do të dënohet në këtë rast nga këto 3 televizione.

Ose në cilin do regjion tjetër? Në ... janë 5 regjione, domethënë ne që e bëjmë që veprojnë, domethënë që kemi licencat rajonale e dimë se çka do të thotë me e mbuluar një regjion ose të madh.

Te Mitrovica pas shumë e shumë luftimeve, dhe betejave, e ka marrë licencën për të mbuluar 3 regjione nga këto 5 të Kosovës. Dhe ky është minimumi për të ekzistuar, domethënë në kufi të ekzistencës. Afërdita e përmendi se 21-shi paguan 0.1 taksë. TV Mitrovica për shembull paguan 6% taksë.

(Ndërhyrje)

Po, të qarkullimit vjetor!

(Ndërhyrje)

Jo, jo ta dokumentoj! S'ka rëndësi, a është shumë. Është e vërtet që është shumë.

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Ju lutem, të mos ndërhyni!

NEXHMEDIN SPAHIU: Nuk mundet me qenë, se nuk janë të ardhurat njësoj, do të thotë as të atyre, se nuk është qarkullimi vjetor njësoj, në qoftë se mendohet në qarkullimin vjetor të 21-shit. Edhe unë po mendoj në qarkullimin vjetor të Mitrovicës.

Po ne jse, unë s'isha duke u ankuar në këtë drejtim, por vetëm e mora për të argumentuar se çka do të thotë për të mbijetuar. Në qoftë se tash me këtë TV Mitrovica një të drejtë të cilën e ka marrë, që e ka dhe licenca i zgjatë deri në vitin 2019 a 2020, tash i shkurtohet përmes këtij ligji, sepse e kufizon në një rajon.

Ka qenë kërkesë unanime e të gjitha televizioneve rajonale, e lokale, që ndarja të mos bëhet në 5 zona por në 2 zona, meqenëse ka mjaft kanale, domethënë me digjitalizim ky numër shtohet, pra nuk zvogëlohet por shtohet. Dhe, të paktën minimumi me qenë i ndarë në dyshe, në mënyrë që me qenë përfshirja....

(Ndërhyrje)

Urdhëro! Do të thotë, po e përcjell kërkesën, nuk e di pse Visari nuk e përcolli këtë se e din që ne e kemi bërë edhe me shkrim edhe me të gjitha dhe nuk e di ku është interesi i Kosovës që me i dëmtuar të gjitha këto televizione. Çfarë, ku është interesi jonë, i secilit veç e veç. Po ku është interesi i Kosovës të dëmtohen të gjitha televizionet, të dënohen. Domethënë me e sqaruar para se të merret një veprim.

Unë po mendoj se ky ligj, njësoj sikur edhe ligjet tjera, dhe me një logjikë e mendësi që po veprohet fatkeqësisht në Kosovë, jo të shfrytëzohet se çka të përfitojë Kosova me këtë, por kush të përfitojë nga kjo, sikur kur të hapet një tender, me këqyrë me u mbaruar rruga, apo çka do të mbarohet në mënyrën më të mirë, por kujt me iu mundësua të vjedh më shumë prej atij tenderi.

Nga ajo që lexova, unë po e shoh këtë tendencë. Nuk është mirë, por do të ketë kanale mjaft. Është edhe një tjetër gjë me rëndësi. Renditja nuk është njësoj sikur të jetë në kanalin 1, 2 ose 5, sikur me qenë atje 180. Kjo ka shumë rëndësi.

(Ndërhyrje)

Nuk e bën ligji, po ne po e bëjmë. Shikoni, ligji edhe e thotë një gjë, ta zëmë. Është shumë laksativ, i mbron produktet vendore. A është ashtu? E tash, po të kallëzoj se KPM-ja ka nxjerrë rregullore në kundërshtim me ligjin dhe ne e kemi thënë këtë sa e sa herë, edhe kemi shpresuar se me zgjedhjen e bordit të ri do të përmirësohet kjo punë, por po e shohim që as këta s'janë burra më të mirë se ata të mëparshmit...

Shikoni çdo televizion vendor pagan takse që hyn në tregun dhe kjo është takse pse hyjmë në tregun e Kosovës, kush ma pak kush më shumë, kujt i peshon por është bërë një mënyrë korrekte ose jo korrekte por për të secili pagan takse.

Televizionet e Shqipërisë e të Serbisë që hyjnë në tregun e Kosovës hyjnë pa kurrfarë takse. Kjo është anomali, që kur po do me ia shpjegua, s'po din as qysh me ia shpjegua se s'po mund të besojë dikush.

(Ndërhyrje)

Jo, në qoftë se ai kabllori i cili do me shti një program i cili nuk është i licencuar në Kosovë duhet me paga takse për atë program që po shtin. Po do me shti SNN, urdhëro paguaj takse se po e shtin SNN.

(Ndërhyrje)

Po pse? Dhe plus asaj, edhe një diçka!

KRYESUESI: Ju lutem, mos ndërhyini!

NEXHMEDIN SPAHIU: Ta përfundoj, pastaj urdhëroni! Për ligj po flasim, për këtë ligj po flasim. Shiko, ligji përcakton se produktet vendore kanë përparësi, a po? Atëherë, në këtë rast edhe programet e huaja do të futen sigurisht aty. Do të duhej të ishin të para programet vendore e me hy edhe Top-kanal numër 5, ose numër 1, një kohë ka qenë, e TV Mitrovica numër 150. Kjo është në kundërshtim me ligjin.

Prandaj, unë nuk di pse bëhen debate publike në qoftë se kur ka një kërkesë unanime, domethënë pa kurrfarë përjashtimi, nga të gjithë aktorët, injorohet ajo. Le të mbetet, do të thotë kjo kërkesa, që të paktën këtu. Do të thotë ky neni 19 duhet të riformulohet, apo neni 18 a s'po e di cili, të riformulohet. Një ndarja, jo në 5, por në 2 rajone dhe të gjitha natyrisht ato që posedojnë licencë në vend kjo nga 2, do të thotë ato që posedojnë licencë valide, të riformulohet kjo. A mundemi ta shënojmë këtë me komente, do të thotë të riformulohet që në vend të 2 të jenë në ato rajone, do të thotë në rajonin përkatës. Ju faleminderit! Më falni se ndoshta ju lodha!

KRYESUESI: Faleminderit zoti Spahiu! Kush e do fjalën?

EKREM HOXHA: Të gjithë të pranishmit, besoj në aspektin teknik që janë, janë më të njoftuar, Konferenca e radhës dhjetëvjeçare botërore World redi konfernc, mbahet në tetor 2015. Pra, kur bëhet ndarja ndërkombëtare, edhe Kosova është duke i bërë të gjitha angazhimet e ARKEP-it për të siguruar një pjesëmarrje së bashku me Ministrinë e Linjës.

Pra është një detyrim ndërkombëtar se u prek këtu, a është detyrim apo nuk është. Mbetet detyrim ndërkombëtar dhe ne si shtet dhe Kuvendi mbi të gjitha ka zotim për t'i afruar me standardet e BE-së dhe për të treguar një pjekuri institucionale ne duhet t'i përvetësojmë ato standarde.

Tjetra. U përmend nga zonja Kelmendi FAK-GIA. Evropa në 2022 do të kalojë në këtë platformë. Pse po e them këtë dhe pse po e përmendi? Platforma apo mediumi i internetit, kabllovi apo transmetimi i DNA përmes IP adresës, protokollit të internetit është e ardhmja. Krejt çka po bëjmë tani, është edhe një medium, një autostradë si e quajti zonja Kelmendi e cila i jepet tregut si mundësi, por nuk do të thotë se kjo mundësi i përjashton aktorët nga tregu.

U përmend edhe puna kush e ka fuqinë e ndjeshme në treg, që po i referohet KTV-ja, 21-shi dhe RTK kanale historike. Analiza e tregut si komponentë ekonomike bëhet nga ARKEP-i. KPM-ja është rregullator i përmbajtjes, pra nuk është rregullator i tregut dhe e ka një administrim, apo quhet menaxhim i radiofrekuencave radiodifuzive. Trendi në BE dhe në regjion është se frekuencat radiodifuzive menaxhohen nga një autoritet që është, fatkeqësisht apo fatmirësisht, ARKEP-i.

Në regjion edhe infrastruktura e hekurudhave ka kaluar në rregullatorë të ARKEP-it, sepse një medium, të gjitha autostradat po unifikohen për të mund me u dhënë në treg. Si jepen në treg – përmes një ligji sikur ky, i cili përcakton kushtet dhe rregullat e fitimit të së drejtës së përdorimit.

Pra, unë i ftoj të gjithë aktorët, edhe pse secili i ka të drejtat legjitime apo shqetësimet e veta, por ligji nuk e përjashton askënd, pikërisht në nenin 19 thotë – maskeri-riull. Kjo e obligon atë që e fiton të drejtën e operimit si operator i multipleksit me bartë sinjalin. Pra, qytetari nuk mbetet pa shërbimin e këtyre prodhuesve. BE dhe shtetet e regjionit janë duke ndarë fonde strukturale nga buxheti i shtetit për ta stimuluar prodhimin. Pra, në qoftë se prodhuesit aktualë të tregut i cenohet atraktiviteti ekonomik, shteti mund të ndikojë me mekanizma tjerë për ta stimuluar prodhimin. Dhe këto janë trende që ne, deshëm s'deshëm duhet t'i përvetësojmë shumë më shpejt. Dhe ARKEP-i i ka bërë të gjitha përgatitjet, i ka bërë vlerësimet e brezit dhe brezin 800 ku do të lirohet dividenda që e përmendi kolega, dividenda 1 dhe 2 dhe ne nga viti i ardhshëm do t'i vendosim në funksion të tregut.

Pra, operatorët do të konkurrojnë për marrjen e atyre resurseve dhe tregu do të masivizohet. Kjo është e bukura e këtij ligji dhe ftoj që krejt këto shqetësime mund t'i debatojmë me terme teknike e profesionale, por të ecim tutje me adoptimin e këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hoxha! Tani e ka fjalën Anita Morina-Saraçi. Kërkojmë falje para se gjithash, se bukur moti e keni kërkuar fjalën!

ANITA MORINA-SARAÇI: Faleminderit!

Vetëm desha të ju them se sikur të kisha përmendur më herët këto vërejtje që i ka dërguar KPM-ja, ndoshta ju kisha nga diskutimet që ishin këtu më herët, sepse besoj që disa nga vërejtjet që i ka bërë KPM-ja përfshihen edhe ankesat ose kërkesat e disa institucioneve këtu që ishin më herët.

Duke mos dashur që tani të diskutoj këtu për strategjinë e cila është një dokument i kryer dhe i miratuar në Qeverinë e Kosovës, vetëm kisha kërkuar që ky projektligj të bazohet në strategjinë që është përpiluar nga KPM-ja dhe miratuar nga Qeveria e Kosovës.

E sa i përket kolizionit në mes ligjeve të KPM-së dhe ARKEP-it unë besoj se Komisioni do ta rregullojë këtë dhe do t'u jepë të drejta secilit prej institucioneve në bazë të asaj që përcaktohet me ligjet për këto institucione dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Mirëpo, desha të potencoj dy çështje, që vlerësoj se duhet të theksohen këtu. Te neni 13, Projektligji për digjitalizim përcakton që me qëllim të transmetimit radio-difuziv digjital të sinjaleve të shërbimit të transmetuesit publik Radiotelevizionit të Kosovës do t'i jipet e drejta për një multipleks për mbulueshmërinë në tërë territorin e Kosovës për pa e kryer procedurën e thirrjes.

Dhe mos të vazhdoj më tutje, është propozimi i KPM-së dhe konsideron se ky nen duhet të harmonizohet me strategjinë për digjitalizim përmes të cilës është paraparë që transmetuesi publik qysh në fazën e parë të ketë multipleksin e vet në mënyrë që të fillojë transmetimin, do të thotë, në fazën e parë në mënyrë që qytetarët të mos mbeten pa informacion nga transmetuesi publik.

Gjithashtu ajo që vlerësoj se duhet të ceket e që është përmendur këtu shumë, është neni 19 paragrafi 1 ku thotë – operatori i multipleksit duhet të sigurojë që rregulli mast-kerry të jetë në multipleks të dy programeve të transmetuesit publik, dy kanale historike televizive kombëtare dhe dy programe rajonale televizive në çdonjërin nga 5 rajonet e Kosovës të cilët kanë të drejtë të transmetojnë programet e tyre televizive duke shfrytëzuar teknologjinë e transmetimit digjital për zonën në fjalë, për aq sa lejon kapaciteti i multipleksit.

Propozimi i KPM-së është që kjo duhet të bazohet në strategjinë e KPM-së e cila përcakton se implementimi i digjitalizimit në nivel nacional bëhet ndaras nga implementimi i digjitalizimit në nivel lokal. Pra parimi i mast-kerryt do të aplikohet gjatë gjithë periudhës tranzitore deri në suich-of të transmetimit analog, për derisa KPM nuk vendos ndryshe.

Kushtet dhe kriteret e bartjes obligative për përmbajtje të caktuara programe do të përcaktohen me rregullore të veçantë.

Dhe, te ajo që u përmend më herët, këto janë propozime të KPM-së që kërkoj të merren parasysht për aq sa është mundësia. Dhe, nëse mendohet për zonën ku përfshihet tërë territori i Kosovës,

atëherë teknikisht nuk është e mundur të realizohet në të njëjtën kohë dhe të arrihet mbulimi nacional dhe nga dy kanale regjionale për çështje të caktuara teknike, sepse është fjala për multipleksa që do të përdoren për mbulim nacional me standardin e transmetimit 2, dhe janë këto rregulla të përcaktuara ndërkombëtarisht dhe në rrjetin SFM.

Ne si KPM e kemi diskutuar shumë këtë qasje dhe teknikët e administratës kanë punuar me mua në këtë çështje dhe është konstatuar se teknikisht është e pamundur që televizionet lokale të transmetojnë në tërë regjionin e Kosovës, do të thotë në multipleks rajonal.

Dhe kërkesa që është bërë më herët, është prej Televizionit të Mitrovicës, dhe shqyrtuar dhe teknikisht është çështje e pamundur. Ne mund ta fusim në ligj, mund ta fusim në strategji, mirëpo teknikisht është e pa implementueshme.

Jemi sqaruar për këtë në dëgjimet publike, dhe kjo është ajo që i përket ligjit për digjitalizim. Unë thashë edhe një herë që nuk desha të diskutoj për strategjinë e cila është dokument i mbyllur dhe për atë edhe pse ne u thirrëm ne shumë si KPM unë nuk dua që të japa përgjigje këtu se ne i kemi kryer përgjigjet me industrinë, sigurisht se ne jemi kapur çdoherë për debate tjera. Mirëpo, ajo që kërkoj për komisionin mbikëqyrës KPM kërkon që në komisionin mbikëqyrës KPM t'i ketë 3 antëtarë, meqenëse u tha edhe këtu, se KPM është përgjegjëse pothuaj se për 10% të digjitalizimit në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zonja Morina-Saraçi! Fjalën e ka edhe një herë Mentor Shala.

MENTOR SHALA: Unë nuk pata ndërmend të flas për këto çështjet e propozimeve të RTK-së dhe rekomandimeve të RTK-së por meqë zonja e përmendi nenin 13, është pikërisht neni 13 ajo pika që na i kemi vërejtjet dhe propozimet tona.

U përmend vetëm gjysma e këtij neni...

(Ndërhyrje)

Mirë, ne po pajtohemi me atë pjesën e parë të nenit, por është pjesa e dytë, është RTK, pjesa e dytë e fjalisë. Thotë: RTK do të përdorë këtë multipleks vetëm për programet e veta dhe nuk mund ta lëshojë atë në përdorim për ndonjë subjekt tjetër.

Ne mendojmë që është njëfarë lloji, të them diskriminimi, për RTK mos me u lejuar me pas edhe kanale tjera. Tash cilat kanale dhe qysh përcaktohet, ne e kemi shembullin me Shqipërinë. Shqipëria na ka marrë neve si RTK në kuadër të platformës së vet digjitale e cila është ende në fazën testuese, mirëpo ne jemi atje me marrëveshje me ta, e tash nuk do të ishte fer ndoshta ne të mos ta kemi, për shembull, në platformën e RTK-së. Ose, edhe pse mos ta shfrytëzuar edhe për programe tjera, për kanale tjera, s'po e kuptoj ku është problemi, sidomos për ato kanale të cilat janë ndoshta ...

(Ndërhyrje)

Jo biznes, por pa biznes, se ne e kemi fri. E kemi fri transmetimin dhe ne mund t'i lëshojmë fri ato kanale që janë të interesuara të lëshohen.

(Ndërhyrje)

Domethënë propozimi ynë është që edhe RTK të ketë mundësinë t'i ketë edhe kanalet tjera, tash së pari ato mas-kery që janë, s'po them më shumë tjera.

KRYESUESI: Faleminderit zoti Shala!

MUHAMET MUSTAFA: Këtu, nuk jemi duke harmonizuar, sigurisht i keni dhënë argumentet, do t'i marrim edhe me shkrim dhe do t'i analizojmë të gjitha. Mendoj se ajo që ne thamë se është me rëndësi, së pari disa gjëra duhet të kihen parasysh. Investimet që i ka bërë kjo industri ne duhet t'i respektojmë dhe t'i pasur parasysh deri tash, mos me i rrezikuar nën një.

Nën dy. Duhet lejuar mundësinë e zhvillimit të mëtejshëm në kuadër të konkurrencës së barabartë të zhvillimit. Domethënë, duke i respektuar investimet, zhvillimit të mëtejshëm, t'i krijohet mundësi edhe aktorëve tjerë të hyjnë në konkurrencë të barabartë. Këto janë parime që ne i mbajmë dhe do t'i mbajmë më tutje dhe në këtë drejtim ne do të mundohemi të bëjmë optimumin prej kësaj sepse e kemi një situatë që e kemi të trashëguar që s'mundemi t'i fshijmë me një gomë. Domethënë, duhet me e marrë atë situatë dhe me i respektuar përpjekjet e investimeve duke filluar prej televizioneve lokale, regjionale e tjera, televizionin publik dhe tjera, por nuk mund ta mbyllim derën për aktorët e ri dhe konkurrencën e barabartë. Kjo është nën një.

Dhe nën tre, duhet të zhvillojmë edhe për zhvillimet e mëtutjeshme, sepse teknologjia zhvillohet dhe ne duhet ta kemi parasysh. Domethënë, zgjidhjet duhet të bëhen fleksibile, jo zgjidhje të ngurta por me i bërë në mënyrë fleksibile që i kanë parasysh të gjitha këto elemente dhe nuk e rrezikojnë asnjërin.

E tash, sigurisht se individualisht nuk mund ta gjejmë optimumin individual për çdo akter, por duhet me e gjetur optimumin në nivel nacional dhe kombëtar. Kjo është me rëndësi.

KRYESUESI: Faleminderit zoti Mustafa! A dëshiron ndokush tjetër të marrë fjalën?

Atëherë, me zotimin se fjalët do t'i mbajmë, po e përmbylli këtë dëgjim publik!

E përqatiti:

Njësia për transkriptim